



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primijsenat / Predato Received / Delivery	13 - 02	2023	3 viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAMSHOK	1689/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1331/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1331/2022 të datës 30.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 13.02.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1331/2022 e datës 30.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Anulohet Njoftimi i datës 27.12.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

III. Obligohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr veprimet juridike për përfshirjen e ankuesit në listën e verifikimit paraprak për pozitën Drejtor i Përgjithshëm-2 në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.942/2022 të datës 08.12.2022, ka obliguar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme që të rishqyrtoj aplikacionin e ankuesit lidhur me pozitën *Drejtor i Përgjithshëm-2* në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë Punëve të Brendshme përmes emailit zyrtar të datës 27.12.2022 ka njoftuar ankuesin për refuzimin e aplikacionit lidhur me këtë pozitë me arsyetimin se nuk ka plotësuar kushtet e konkursit respektivisht atë të kualifikimit profesional duke e njoftuar tutje se kualifikimi i studimeve master nuk është i fushës së nivelit të studimeve bachelor si rrjedhje nuk ka plotësuar kushtin prej 240 si është kërkuar në konkurs.

Ankuesi kundër këtij njoftimi, më datë 30.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 8666/2022 të regjistruar me numër A.nr.1331/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka bërë verifikim të aplikacionit në pajtim me legjislacionin në fuqi pasi që nuk ka marr informata zyrtare lidhur me diplomën e nivelit bachelor dhe master; nuk është zbatuar vendimi i Këshillit sepse në bazë të dokumentacioneve i plotësoj të gjitha kushtet e konkursit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8666/2022 të datës 30.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me provat e bashkangjitura, Vendimin Anr.942/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të datës 08.12.2022 me numër protokollit 7812/2022, E-maili i datës 11.10.2022 E-maili i datës 17.10.2022, 14.10.2022, 12.10.2022, 11.10.2022, E-maili i datës 27.12.2022 Njoftim; E-mail nga ankuesi i datës 28.12.2022 kërkesë për qasje ne dokumente publike, Diplomë Universitare Nr.206 e datës 15.02.2015; Diplomë Universitare Nr.1371 e datës 10.03.2014 e ankuesit, E-mail i datës 29.12.2022 nga ankuesi, E-mail nga SH.G e datës 29.12.2022, Vendimi i datës 18.07.2022 ref:948/2022 i lëshuar nga Agjencia Kosovare për Akreditim(ri-akreditim), Vendimi i datës 12.08.2022 ref:3016/21 i lëshuar nga Agjencia Kosovare për Akreditim,(riakreditim); Plotësim i ankesës së ankuesit me datë 18.01.2023, duke bashkangjitur: shkresë datës 20.10.2002 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", nr. 327 lënda: propozim për regjistrimin e studenteve në studime master; kopje e konkursit të datës 13.12.2005; Lista e Regjistrimit nr. 107/3 i datës 03.09.2006 , Lista e kandidatëve për regjistrim Nr.75 i datës 06.03.2006, Fleteregjistri me numër amëze/120262005 i ankuesit në Departamentin e Teknologjisë Universiteti i Prishtinës, me fletëpagese të datës 10.03.2006; E-mail i datës 11.01.2023 nga B.K; Email i datës 11.01.2023 nga I.XH; Email i datës 28.12.2022 nga ankuesi për B.K. cc Q.Q; Ankesën me numër të protokollit 6439/2022 të datës 25.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e DMZ-së lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit; Diplomën me Nr.715 të datës 23.07.2020 te ankuesit; Diplomën me Nr.29/18 të datës 30.05.2018; Diplomën me NR.229/03009 të datës 30.03.2000; Diplomën me numër 001101-1 të datës 06.06.2005; Dëftesën me Nr.541-VIII të datës 30.05.2001; Konkursin e datës 24.08.2022 me numër reference RN000009813; Konkursin

datës 16.09.2021 me numër reference. RN00007618; Pasqyrën e llogarisë Trustin për periudhën kohore 29.09.2010 deri me datën 16.08.2022; Ankesën e ankuesit drejtuar Njesisë Përgjegjëse ne DMZP; Njoftimin e datës 15.11.2021; Emalin e datës 25.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6589/2022 të datës 21.10.2022; Përgjigjen me numër të protokollit 6991/2022 të datës 10.11.2022; Vendimin me NR.04/73 të datës 30.04.2022 lidhur me emërimin e Komisionit Shtetëror për Pranim për pozitat e kategorisë së lartë drejtues në këtë përbërje; Njoftimin e datës 11.10.2022; Dosjen e datës ankuesit; Aplikacionin e datës 26.09.2022; CV; Vërtetimin e datës 29.04.2021; Certifikatën e datës 29.04.2021; ID kartelën me numër 13264; Urdhër emërimin e datës 18.12.2009; Aktin përcjellës të datës 12.11.2012; Vendimin (pa numër dhe datë); Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të "Module Bourse" për periudhën kohore 26.10.2009 deri me 11.12.2009; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit " Junior commanders Cadre" të datës 25.03.2010; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin 31 Gushtë deri më 31 Tetor 2010; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " Using and holding eapons" të datës 17.1.2010; Shkresën nën shenjen Lrp.nr.4303/2020 lidhur me motorizimin e diplomës me nr.715; Diplomon me Nr8072/08 të datës 31.03.2008; Ceetifikaten me numër 5549/07 të datës 08.03.2007; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Bsataljonit", për Reagim të Shpejtë për periudhën kohore 31.08 deri me 31 Tetor 2010; Certifikatën me Nr.regjistrit.1284 të datës 17.12.2010 lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit " përdorimi dhe bartja e armëve"; Kontratën me numër te protokollit 295 të datës 09.02.2022; Certifikatën e datës 2411.200; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën me numër CN.nr.206/2022 të datës 06.07.2022 Certifikatën e datës 06.07.2022 nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykate; Vërtetimin e datës 01.09.2021; Emalin e datës 26.09.2022; Vërtetimin e datës 15.09.2022; Vërtetimin e datës 15.07.2022; Dosjen e kandidatit B.H; Diplomën me Nr.212 të datës 05.07.2006; Shkresën (pa numër dhe datë) e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës lidhur me informacionet identifikuese të bartësve të kualifikimeve; Certifikatën e 17-19.05.2017 lidhur me trajnimin të mbajtura; Certifikatën e 16-21.05.2016 lidhur me trajnimin e mbajtur; Certifikatën e datës 08-12.02.2016 lidhur me trajnimin mbajtur; Certifikatën e datës 30.03.2015 deri me 30.04.2015 lidhur me trajnimin mbajtur; Certifikatën e datës 09.13.2015 lidhur me trajnimin e mbajtur; Certifikatën e datës 02-06.02.2015 lidhur me trajnimin e mbajtur; Certifikatën e datës 26-30.01.2015 lidhur me trajnimin e mbajtur; Certifikatën e 19-23.01.2015 lidhur me trajnimin e mbajtur; Certifikatën e datës 29.10.2014 lidhur me përfundimin e trajnimit " Pajisjet e gjeneratës me te re për sigurinë e ushqimit dhe aplikacionet mjedisore"; Certifikatën e datës 25.08.2005 lidhur me trajnimin e mbajtur; Certifikatën e datës 22.06.2004 ne shenje mirënjohje; Certifikatën e datës 04.10.2003; Certifikatën e datës 18.04.2003; Certifikatën lidhur me çmimin e aftësues (pa datë dhe numër); Certifikatën e datës 01.08.20000 lidhur me çmimin e aftësues; Certifikatën pa datë dhe numër lidhur me çmimin e aftësues për periudhën kohore 06-2000 deri me 06-2001; Certifikatën e datës 19-23.01.2015 lidhur me përfundimin e trajnimit "EN-ISO/ICE 17 025 for calibration laboratoris"; Certifikatën e datës 22.06.2004; Certifikatën lidhur me përvojën e punës për periudhën kohore 03.11.2008 deri me 24.12.2011; Vërtetimin me numër të protokollit 1294 të datës 10.03.2014; Akt emërimin e datës 21.08.2014; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 04.09.2014; Dokumentin e identifikimit; Formularin e vlerësimeve të punës të datës 31.01.2022 për nëpunësit civil dhe nëpunësit e shërbimeve publike për kategorinë drejtuese i mesës, i ulëte dhe profesional; Formularin e vlerësimeve të punës të

datës 29.01.2021 për nëpunësit civil dhe nëpunësit e shërbimeve publike për kategorinë drejtuese i mesës, i ulëte dhe profesional; Vërtetimin e datës 27.09.2022; Letër motivimin e datës 26.09.2022; Certifikatën e datës 27.09.2022 nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Letrën motivuese të datës 26.09.2022; Certifikatën e datës 25.06.2014; Vendimin me numër të protokollit 2232 të datës 12.02.2016; Ndryshim dhe plotësimin e akt emërimit të datës 02.12.2019; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 03.12.2019; Vendimin me numër Ref.152 të datës 17.09.2021; Dosjen e kandidatit I. E; Aplikacionin e datës 30.09.2022; Diplomën me Nr.621 të datës 01.07.2002; Vërtetimin e datës 07.02.2007 lidhur me përvojën e punës; vërtetimin me Nr.40 të datës 22.01.2007; Certifikatën lidhur me punësimin e kandidatit nga data 01.04.2004 deri me 31.04.2006 në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; Vërtetimin e datës 28.12.2007; Akt emërimin e datës 05.01.2012; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 02.04.2012; Dokumentin e identifikimit; Letrën motivuese të datës 27.09.2022; CV; Certifikatën e datës 27.09.2022 nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Shtojca e diplomës të datës 21.01.2020; Vërtetimin nga marrëdhënia e punës të datës 27.09.2021; Letër motivimin të datës 27.09.2022; Dokumentin e identifikimit; Vërtetimin e datës 27.09.2022; Certifikatën e datës 20.08.2004; Certifikatën e datës 14-18.0123013 ; Certifikatën me numër UME.BEL010.2013.16E të datës 13.05.2013; Certifikatën me numër 990.2013 të datës 15.05.2013; Certifikatën me numër UME.G2HY-990.2013.2.E të datës 22.05.2013; Certifikatën me numër UME.G1KS-990.2013.20.E të datës 23.12.2013-27.12.2013; Shkresën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin pese ditore ne universitetin e Lublajnjes për periudhën 09.12.2013 deri me 13.12.2013; Certifikatën e datës 19-23-01.2015 lidhur me përfundimin e trajnimit "Trajning En ISO/IEC17025 for Calibration" Certifikatën e datës 02-06.02.2015 lidhur me përfundimin e trajnimit "Trajning on ENISO/IEC17 020"; Certifikatën e datës 14-17.09.2015 lidhur me përfundimin e trajnimit " Meetrologicial Surveillance of Measuring instruments"; Certifikatën e datës 26-30.10.2015 lidhur me trajnimin "Verifikation of NAËI"; Certifikatën e datës 12-16.10.2015 lidhur me përfundimin e trajnimit "Transposition of the mid"; Certifikatën e datës 01-11.12.2015 lidhur me përfundimin e trajnimit Metrological requirements for pre-packaged products and MCB"; certifikatën e datës 17-21.10.2016 lidhur me trajnimin "Pre-Package Products", Certifikatën e datës 13-15.06.2017 lidhur me trajnimin Trasnposion of mid; Certifikatën e datës 19-20.06.2019; Certifikatën për pjesëmarrjen ne trajnimin "Teknikat dhe pranimet e menaxhimit"; Certifikatën e datës 23-24.09.2014 për pjesëmarrjen ne trajnimin "Procesi i vlerësimit ne organizate"; Certifikatën lidhur me përfundimin trajnimit Komunikimi konfliktet dhe puna ekipore për periudhën 24-02.06-03.2015; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " Përafrimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e Bashkimit Evropian" për periudhën kohore 30-31.Janar deri me 02.02.2017; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "VNR dhe Hartimi i Koncept Dokumenteve" për periudhën kohore 16-17.03.2016; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Lëvizja e lire e mallrave" për periudhën kohore 12-14.02.2019; Certifikatën e datës 23-24.03.2021; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit të datës 23. deri me 25.11.2021; Certifikatën e datës 21.09.2022 lidhur me pjesëmarrjen ne aktivitetin e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; Vendimin me Nr.02, ref.300 të datës 30.09.2013; Emalin e datës 24.10.2022 të A.K drejtuar Sh.Leci; Emalin e datës 01.12.2022 të A.K drejtuar KPMSHCK-së;

Emalin e datës 24.10.2022 të A.K drejtuar B.E; Diplomën me numër 229/03009 të datës 30.03.2000.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 24.08.2022 ka shpallur Konkursin me Nr. Reference RN00009813 për pozitën e punës *Drejtor i Përgjithshëm-2* në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Fillimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur se kërkesat e përgjithshme formale për praninë në pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

- *Arsinimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me se paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në shkenca të natyrës, teknologji, inxhinieri ose matematikë (STEM), administratë, ekonomik ose juridik, me specializim që ndërlidhet infrastrukturën e cilësisë.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë se paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi ka aplikuar në konkursin në fjalë me datë 30.09.2022, mirëpo Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datë 11.10.2022 (përmes emalit) ka njoftuar të njëjtin se nuk mund të vazhdojë me procedurë të mëtejme të rekrutimit për këtë pozitë me arsyetimin se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi, diplomën e studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në njërin nga fushat e kërkuara me konkurs, ndërsa ankuesi, me datën 14.10.2022 i është drejtuar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me kërkesë - ankesë për rishqyrtim të aplikacionit, ndërsa ky i fundit pas riverifikimit të aplikacionit me datë 17.10.2022 ka njoftuar ankuesin me arsyetimin e njëjtë se nuk ka ofruar dëshmi, Diplomën e studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, duke e udhëzuar palën që në raste pa kënaqësi mund të parashtroni ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës. Ndaj të cilit njoftim ankuesi me datë 25.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimi Civil të Kosovës.

Me datë 08.12.2022 Këshilli ka nxjerr Vendim me numër A.nr.942/2022 me të cilin ankuesit i ka aprovuar ankesën si të bazuar dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve, me detyrim për rishqyrtimin e aplikacionit me numër RAN008221 të datës 30.09.2022, ndërsa pas rishqyrtimit të aplikacionit ankuesi është njoftuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që nuk ka plotësuar kushtet e konkursit respektivisht Diplomën e studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, duke u njoftuar se me Rregulloren (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil është përcaktuar se *"në rastin kur kreditë janë mbledhur ai pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Bachelor të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor"*.

Lidhur me ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar pretendimet e tij ankimore duke theksuar se ankuesi posedon Diplomën me Nr. 1371 të datës 10.03.2014 të lëshuar nga Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Departamentin e Kimisë-Drejtimi Arsimor duke marr titullin Bachelor i Kimisë-Arsimor me 180+1 kredi ECTS, posedon Diplomën me Nr. 206 të datës 25.02.2015 të lëshuar nga Fakulteti i Gjoeshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet në Departamentin e Teknologjisë Inxhinieri e Mbrojtjes së Mjedisit dhe duke marr titullin Master i Shkencave Teknike me gjithsej 120 pikë ECTS.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil respektivisht Shtojcës 1/2 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për klasën Drejtues i Lartë 2, ku tek arsimimi kërkohet *Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to*, ndërlidhur me këtë Kolegji i Këshillit, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në bazë të njoftimit të datës 27.12.2022 lidhur me rivlerësimin e aplikacionit të ankuesit ka bërë shkelje të dispozitave procedurale dhe ligjit material sepse arsyetimi i lartcekur që e ka dhënë Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë vie në shprehje në rastet e pozitave të kategorisë profesionale konkretisht profesional 1, siç parashihet me Shtojcën Nr. 1/8, ku për arsimimin kërkohet *"Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor)"*, ndërsa për pozita të kategorisë së lartë drejtuese nuk është ky kusht.

Bazuar në këtë Kolegji i Këshillit, duke ju referuar kritereve të konkursit po ashtu edhe përgatitjes profesionale të ankuesit, konstaton se ankuesi posedon diploma të nivelit 240 kredi apo ekuivalente me to në fushën në të cilën kërkohet, si rrjedhojë duke marr parasysht këto fakte Kolegji i Këshillit vlerëson që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me rastin e mos përfshirjes së ankuesit në listën e ngushtë në procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me Nr. Reference RN00009813 për pozitën e punës *Drejtor i Përgjithshëm-2* në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nuk ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe nuk ka zbatuar drejtë dispozitat materiale duke vepruar në kundërshtim me nenin 40 paragrafi 5 nën paragrafi 5.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 8 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: 2. *Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak.* 3. *Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë konkurrimin në fazën e vlerësimit profesional"*, ngase verifikimin e aplikacionit të ankuesit e ka bërë duke mos marrë për bazë kriteret e konkursit si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi i ankuesit se Departamenti për

Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka bërë verifikim të aplikacionit në pajtim me legjislacionin në fuqi pasi që nuk ka marr informata zyrtare lidhur me diplomën e nivelit Bachelor dhe Master është pretendim i bazuar për faktin se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si njësi përgjegjëse për verifikimin e aplikacioneve të kandidatëve të cilët aplikojnë në pozita të kategorisë së lartë drejtuese bënë verifikimin sipas dokumentacioneve që dorëzojnë kandidatët në procedurë, mbi këtë bazë ankuesi ka ofruar dëshmi për plotësim të kriterëve të konkursit respektivisht arsimimit të kërkuar, si rezultat i kësaj Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka vepruar sipas konstatimeve të dhëna në Vendimin A.nr.942/2022 të datës 08.12.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse njoftimi i datës 27.12.2022, nuk përmban arsytetime të sakta dhe konkrete lidhur me natyrën e vendosjes.

Nga të cekurat si më lartë, Kolegji konstaton se në pajtim me këtë vendim respektivisht pikës III të dispozitivit të këtij vendimi, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme është i obliguar që të ndër marr veprimet juridike për përfshirjen e ankuesit në listën e verifikimit paraprak për pozitën *Drejtor i Përgjithshëm-2* në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciumi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1331/2022

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

